

## NË EMER TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ** - Departamenti i Pergjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarës M.Sh., nga fshati .....,Komuna Shtime, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2405-6/14 e dt.07.08.2015 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Visar Musa,të akuzuarës, me dt. 04.10.2016 solli dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

E akuzuara M.Sh., me vendbanim në fshatin .....,Komuna Shtime, data e lindjes.... në ....., nga i ati I. dhe e ëma S., e gjinisë H., shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollen e mesme,modele, mbrohet në liri me numër personal .....

### ËSHTË FAJTORE

#### Sepse:

- me datën 21.09.2014, rreth orës 22:00, në fshatin Sojevë, Komuna Ferizaj, në Restorantin “.....”, me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme e që vetit t’i sjellë përfitime pasurore të kundërligjshme, gjerësa ishte në mbramje soleme nga çanta e të dëmtuarës E.Th. kishte marrë telefonin “Iphone4S”, ngjyrë e bardhë, me numër serik: ....., vlera e telefonit sipas të dëmtuarës është 300 Euro, më pas telefoni ishte konfiskuar nga ana e policisë dhe i’u kishte kthyer të dëmtuarës,-

*- Me të cilën kreu veprën penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së.*

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, dhe 73 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së

### G J Y K O N

Të akuzuares **M.Sh.**, i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 150 /njëqindë e pesëdhjetë / Euro, të cilin denim me gjobë është i obliguar ta paguaj nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rastë se e denuara nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t’i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t’i llogaritet një (1) ditë burgim.

E dëmtura E.Th.,së bashku me përfaqësuesin ligjor-prindin I.Th. nga Gjilani, rruga “.....” për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale- paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2405-6/14 e dt.07.08.2015 ka akuzuar të akuzoren M.Sh., me vendbanim në fshatin ....., Komuna Shtime, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Duke vepruar në këtë çështje penale gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me dt.04.10.2016, në të cilin gjyqtari ka ftuar të akuzuaren të përcjellë me vëmendie zbatimin e shqyrtimit gjyqësor dhe e ka udhëzuar në kuptim të nenit 323 parag.2.1,2.2 dhe 2.3 të KPPK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor prokurori i shtetit Visar Musa, ka mbetur në tërësi pran akuzës së ngritur nga ana e prokurorit të shtetit si dhe kualifikimit juridik për veprën penale e cila i vehet në barrë të akuzurës, nga baza e pranimit të fajësisë nga e akuzuara i cili pranim gjenë mbeshtetje të plotë edhe në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës, i ka propozur gjykatës që të njëjtën ta shpallë fajtorë dhe ti shqiptoi sanksion penal të parapar me ligj përmes të cilit do të arrihet qëllimi ndëshkimor, ndërsa me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethana lehtësuese për të akuzoren të merr pranimin e fajësisë dhe këthimin e telefonit të dëmtuarës.

E akuzuar M.Sh. në shqyrtimin gjyqësor ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, dhe në mbrojtjen e saj ka deklaruar se telefonin për të cilën akuzohet e kishte gjetur në Restaurant “.....” në fsh.Sojevë ku ka marrë ljesë në mbramjen e sfulatës për zgjedhjen e “.....”, po ta kishte ditur se do të ngarkohej për veprën penale që akuzohej nuk do ta kishte marrur dhe posa është njoftuar nga polici atë i’u ka dorëzuar atyre e më pasë i’u ka dorëzuar të dëmturës, për veprën penale që është ngarkuar nga prokuroria është penduar , i kërkon fale të dëmturës,telefonin ja ka kthyer policia ka premtuar se më këso veprime nuk do të përsërisë i ka propozuar gjykatës me rastin e shqyrtimit të dënimit të merrë për bazë pranimin e fajësisë për verën penale që është akuzuar.

Gjyqtari në shqyrtimin gjyqësor pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarës ka vlerësuar se janë përmbushur kërekesat nga neni 326 par.4 i KPPK-së, pasi e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, fajin e ka pranuar vullnetarishtë duke e mbeshtetur në provat dhe materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit të cilat gjenden në shkresat e kësaj lënde penale dhe shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtarëve të palëve konform nenit 352 të KPPK-së.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor konstatoi se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde gjegjësishtë në kallximin penal me nr.2014-CF-2121, të dt.30.09.2014, vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 22.09.2014 dhe vërtetimin mbi kthimin e sendeve të dt.23.09.2014dhe deklaratat e dhëna në polici.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes se llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e tij në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, si rrethanë veçanërisht lehtësuese për të akuzuarin gjykata mori pranimin e fajësisë nga ana e saj, pendimin për veprën penale për të cilën është akuzuar kërkim falje të dëmturës i është kthyer telefonin “Iphone4S”, mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarës dhe rrezikshmerinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 150 /njëqindë e pesëdhjetë / Euro, të cilin denim me gjobë është i obliguar ta paguaj nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, duke qenë i bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarës dhe me të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së, e dëmtura E.Th., së bashku me përfaqësuesin ligjor-prindin I.Th. nga Gjilani, rruga “.....” për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Vendimi mbi kompensimin e paushallit gjyqësor është sjellë në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**P nr.963/2015, datë 04.10.2016**

**Asistenti**  
Muedin Rexhepi

**Gjyqtari**  
Adem Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.